



# **RAPORTI VJETOR I PUNËS SË AGJENCISË SHETËRORE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS**

**Viti 2020**

Më poshtë është paraqitur aktiviteti i Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës për vitin 2020, bazuar në objektivat dhe drejtimet kryesore të punës së institucionit:

### **1. Monitorimi i menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.**


Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës (ASHMDF) është përgjegjëse për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, në zbatim të politikave kombëtare për mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna. Ajo mbledh të dhëna në nivel kombëtar për mbrojtjen e fëmijës dhe analizon nevojat për ndërhyrje specifike në fushën e mbrojtjes së fëmijës.

Ligji 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” institucionalizon Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF) dhe Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës (PMF) si struktura për koordinimin dhe vënien në zbatim të shërbimeve të mbrojtjes së fëmijës dhe menaxhimit të rasteve, në bashkëpunim me një numër aktorësh të fushave të ndryshme, që veprojnë në nivel vendor.

Bazuar në VKM Nr. **636**, “Për llojet dhe mënyrën e shkëmbimit e të përpunimit të informacionit dhe të dhënave statistikore të kërkuara nga ASHMDF nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”, NJMF-të, raportojnë periodikisht, çdo tre muaj dhe një herë në vit për punën e tyre në menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje nga dhuna, abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi. Në bazë të raportimit vjetor të NJMF është hartuar raporti me të dhëna në shifra mbi punën dhe rastet e menaxhuara nga NJMF për vitin 2020 për 61 bashkitë.

Gjatë vitit 2020 shifrat tregojnë për një total prej **2193 fëmijë të trajtuar gjithsej** nga NJMF në nivel kombëtar. Rastet e menaxhuara janë kryesisht raste të fëmijëve në rrezik apo viktimat të dhunës, abuzimit, neglizhencës apo shfrytëzimit. Nga këto, janë identifikuar **1020 raste të reja**.

Nga raportimet rezulton se 54 NJMF kanë menaxhuar të paktën një rast dhe 7 NJMF nuk kanë menaxhuar asnjë rast për vitin 2020. Edhe pse një numër i vogël i NJMF që nuk kanë menaxhuar asnjë rast, këto shifra tregojnë se ka akoma punë për t’u bërë nga ana e NJMF në identifikimin e rasteve të fëmijëve në rrezik për mbrojtje por edhe në rritjen e bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse. Ndërkohë për vitin 2020 janë mbyllur 530 raste sipas arsyes përkatëse.



Numrin më të madh të rasteve të menaxhuara e raporton NJMF e bashkisë Tiranë, duke qenë se kjo bashki ka dhe numrin më të madh të njësisve administrative. Numër të madh rastesh kanë raportuar edhe bashkitë Shkodër, Kamëz, Durrës, Fier.

Përsa i përket numrit të rasteve të reja (1020 raste) të identifikuar sipas grupmoshës, vihet re një numër më i madh i fëmijëve të grupmoshës 13-15 vjeç, me 228 raste të reja për vitin 2020, ndërkohë grupmosha 0-3 vjeç ka pasur numrin më të vogël të rasteve të identifikuar, me 127 raste. Gjithashtu, NJMF kanë trajtuar 136 raste të grupmoshës 4-6 vjeç, 159 raste të të grupmoshës 7-9 vjeç, 164 raste të të grupmoshës 10-12 vjeç si dhe 206 raste të të grupmoshës 16-18 vjeç.

Për vitin 2020 numrin më të lartë të rasteve të reja të trajtuara nga NJMF e zenë meshkujt me 547 raste, ndërkohë femrat kanë qenë në shifrën e 473 raste.


Për vitin 2020, 155 e rasteve të reja të identifikuar nga NJMF i përkasin komunitetit rom, 111 raste të komunitetit egjiptian, 681 raste i përkasin popullsisë mazhoritare dhe 73 raste të fëmijëve me shtetësi të huaj.

Detyrimi për raportim i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje përfshirë ata në rrezik, parashikohet në mënyrë të detyrueshme për të gjithë punonjësit të cilët punojnë me fëmijët. NJMF raportojnë pranë Agjencisë rastet e identifikuar/referuara të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ndaj fëmijëve qoftë nga vetë ata si punonjës të NJMF si persona përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve, por edhe nga aktorë publikë dhe jo publikë apo dhe struktura të tjera përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve dhe që bashkëpunojnë ngushtësisht me NJMF.


Në grafikun e mëposhtëm vihet re që numri më i madh i raste është identifikuar nga policia, 295 raste, por edhe vetë NJMF kanë identifikuar një numër të konsiderueshëm rastesh, 224 raste. Ndonëse në shifra të vogla (12 raste) fëmijët vetë kanë referuar dhunën apo problematikën pranë strukturave përgjegjëse. Prindërit kanë raportuar 73 raste, OJF kanë referuar 97 raste dhe administratori i ndihmë ekonomike 30 raste.

Institucionet arsimore kanë raportuar një numër më të lartë rastesh (68 raste) krahasuar me institucionet shëndetësore (13 raste) edhe pse një numër më i madh rastesh abuzimi apo dhune paraqitet pranë këtyre institucioneve për të marrë ndihmën e parë.


Gjithashtu, një kontribut të rëndësishëm në identifikimin dhe referimin e rasteve kanë dhënë edhe mediat, qytetarët, skuadrat e terrenit, shërbimet sociale rajonale, Avokati i Popullit, gjykata etj. Këto raportime janë paraqitur në kategorinë “Të tjerë” në grafikun më poshtë.



Gjatë vitit 2020, **janë mbyllur 530 raste**. Numri i rasteve të reja të identifikuar është më i madh se rastet e mbyllura. Kjo nënkupton se një numër i madh rastesh mbarten ose vazhdojnë të menaxhohen në vitin në vazhdim. Numrin më të madh të rasteve, 261 raste e zënë rastet të cilat janë mbyllur për shkak të reduktimit të nivelit të rrezikut, në rrezik të ulët ose mungesë rreziku. Kjo është një e dhënë pozitive, pasi tregon se janë marrë masat e duhura për të ndryshuar situatën ku ndodhet fëmija drejt uljes apo eliminimit të rrezikut. Pjesa tjetër është mbyllur për arsye të arritjes së moshës madhore apo transferimit në një vendbanim tjetër. Gjithashtu për vitin 2020 kemi edhe një rast humbje jete.



Një hap i rëndësishëm i menaxhimit të rastit lidhet me vlerësimin e nivelit të rrezikut të çdo rasti të referuar dhe të identifikuar të fëmijës në nevojë për mbrojtje. Sipas raportimeve rezultojnë se në përgjithësi NJMF-të trajtojnë raste me rrezikshmëri të ulët dhe të mesme. Bazuar në raportimet e NJMF-ve për vitin 2020, numri më i madh i rasteve të trajtuara kanë qenë raste me rrezik të mesëm, 1058 raste dhe me rrezik të ulët 735 raste. Gjithashtu, NJMF kanë menaxhuar 255 raste me rrezik lartë, ndërsa rastet emergjente të trajtuara janë 145 raste.



Gjatë vitit 2020 janë realizuar 2424 vizita në familje për 2193 raste të menaxhuara. Vizitat në familje kryhen nga NJMF me qëllim identifikimin e rasteve të reja, vlerësimin e fëmijës dhe familjes si dhe monitorimin e rasteve që janë në menaxhim, etj.

Në totalin e rasteve të menaxhuara rezulton se problematikat e rasteve të fëmijëve në nevojë që janë trajtuar nga PMF-të janë të ndryshme dhe NJMF në bashkëpunim me aktorë të tjerë kanë siguruar shërbimet, ndërhyrjet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijëve. Rastet më të shumta të fëmijëve të marrë në mbrojtje nga NJMF i përkasin fëmijëve që jetojnë në familje me probleme social ekonomike. Vlen të theksohet problemet social ekonomike në familje në vetvete, nuk janë kritere të mjaftueshme që NJMF të hapin procesin e menaxhimit të rasteve. Por nëse fëmijët që jetojnë në kushte të tilla, përjetojnë mohim apo mungesë në akses të të drejtave themelore, atëherë ata merren në mbrojtje nga NJMF. Për vitin 2020 janë menaxhuar 791 raste të tilla.

Rastet e neglizhimit gjithashtu janë një problematikë që zë një numër të madh rastesh. Për periudhën raportuese janë menaxhuar 311 raste nga NJMF-të. Shumica e rasteve të neglizhimit të fëmijëve kanë ndodhur në familje më probleme të theksuara ekonomike, apo në rastet e neglizhencës së prindërve për të ushtruar të drejtën për arsim të fëmijëve, apo raste ekstreme kur prindër të papërgjegjshëm kanë braktisur fëmijët dhe i kanë lënë pa asnjë lloj kujdesi.

255 raste të fëmijëve në situatë rruge janë marrë në mbrojtje nga NJMF për vitin 2020. Numri më i madh i rasteve janë identifikuar nga skuadrat e terrenit në bashkitë ku zbatohet plani i veprimit për fëmijë në situatë rruge. Ngritja dhe funksionimi i skuadrave të terrenit është realizuar në zbatim të planeve lokale për fëmijë në situatë rruge.

Fëmijët me aftësi të kufizuar gjithnjë e më tepër janë në fokus të punës për NJMF-të. Riaftësimi dhe integrimi i tyre në shkolla dhe aktivitete të tjera është në fokus të punës së NJMF-ve. Për vitin 2020 janë trajtuar 34 raste të fëmijëve me aftësi të kufizuar.

Rastet e fëmijëve në konflikt me ligjin janë një problematikë që po trajtohet në bazë të ligjit nga NJMF. Gjithsej raportohen 58 raste të trajtuara nga NJMF, të cilat kanë ndërhyrë duke hartuar dhe zbatuar planin e riintegritit të këtyre fëmijëve, referimin në institucione arsimore, monitorimit ditor të fëmijës, vizita në familje, referim të zyrat e punësimit apo kurseve profesionale. Gjithashtu, NJMF për vitin 2020 kanë trajtuar 58 raste të trafikimit.

Për vitin 2020 janë trajtuar 33 raste të fëmijëve të pargjistruar në gjendjen civile, në të shumtën e tyre janë raste që kanë lindur jashtë vendit dhe për shkak të mungesës së dokumentacionit dhe pamundësisë ekonomike të familjeve për të ndjekur procedurat, mungesës së informacionit mbi procedurat. NJMF-të të cilat kanë informacionin e duhur për regjistrimin e fëmijëve të pargjistruar, kanë mbështetur familjet dhe shpesh i shoqërojnë vetë ato në zyrat e gjendjes civile për regjistrim të tyre.


Problematika e dhunës ndaj fëmijëve zë një vend të gjerë në problematikat e trajtuara. Sjelljet agresive dhe dhuna ndaj fëmijëve janë një problem serioz që rrezikon zhvillimin, mirëqenien e fëmijëve, çënojnë të drejtat themelore, dinjitetin dhe mund të rrezikojnë jetën e tyre. Gjatë vitit 2020 NJMF kanë menaxhuar raste të dhunës psikologjike, dhunës fizike dhe asaj seksuale tek

fëmijët. Për vitin 2020 janë trajtuar 128 raste dhune fizike ndaj fëmijëve. Dhuna ndodh kryesisht në familje, ku fëmijët dhunohen nga babai, por dhe nga nëna apo persona të afërm në familje.

Gjatë periudhës raportuese NJMF kanë trajtuar rreth 224 raste të dhunës psikologjike. Dhuna psikologjike zakonisht është prezente tek fëmijët, kur mes prindërve ka konflikte dhe dhune fizike dhe psikologjike, kur fëmijët janë të pranishëm dhe dëshmitarë të situatave të dhunës, kur prindërit janë në proces të vështirë divorci e vendosin fëmijët në situata të vështira familjare.

Rastet e dhunës seksuale me fëmijët, konsiderohen rastet më të rënda të dhunës ndaj fëmijëve. Për vitin 2020 janë trajtuar 65 raste. Abuzimet me fëmijë kryhen zakonisht nga persona të afërm, të cilët kanë besimin e fëmijëve dhe të familjeve të tyre. Abuzimi ka ndodhur dhe në raste kur vajzat adoleshente mashtrohen nga persona më të rritur të cilët abuzojnë me to.

Gama e problematikave që janë trajtuar nga NJMF-të është shumë e gjerë. Përveç problematikave të sipër përmendura ka dhe raste të tjera që janë trajtuar nga NJMF. 234 raste janë problematika të cilat janë cilësuar tek indikatorët “të tjera”. Këtu përfshihen problematika si braktisje shkollore, mungesë e përkujdesit prindëror për fëmijët, kujdestari të fëmijëve, martesat e hershme, fëmijë me shtetësi të huaj, abuzim online, sjellje devijante, riatdhesim etj.



Bazuar në ligjin 18/2017 përcaktohen masat e mbrojtjes që mund të aplikojnë NJMF, kur konstatojnë raste të fëmijëve që janë në situatë të pasigurt për shkak të dhunës, abuzimit, neglizhimit apo shfrytëzimit. Për vitin 2020 NJMF kanë marrë 75 masa emergjente të mbrojtjes,

për largimin e fëmijës nga familja dhe vendosjen në përkujdesje alternative. Këto përfshijnë, masat emergjente për ta larguar fëmijën nga një situatë rreziku në mënyrë të menjëhershme. Ndërkohë janë marrë 68 masa të mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative.

Gjithashtu, ligji parashikon si masë mbrojtje mbikëqyrjen e specializuar të fëmijës në mjedisin familjar. Mbikëqyrja e specializuar në mjedisin familjar vendoset si masë mbrojtjeje për fëmijën, i cili ka mundësi të trajtohet dhe të mbrohet brenda familjes, duke u monitoruar me një plan të përcaktuar nga strukturat e mbrojtjes së fëmijës. Për vitin 2020 janë aplikuar 85 masa të mbrojtjes për mbikëqyrjen e specializuar të fëmijës në mjedisin familjar.

## **2. Mbrojtja e femijeve në periudhat e fatkeqësisë natyrore apo pandemisë së COVID-19.**

### ***2.1 Mbrojtja e fëmijëve në nevojë në zonat e prekura nga tërmeti***

Në zbatim të VKM Nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë” Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ka vënë në dispozicion burimet njerëzore dhe logjistike të institucionit, për të ndihmuar në terren fëmijët dhe familjet e dëmtuara nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019.

Në zbatim të Urdhrit nr. 410/1 prot, datë 27.11.2019, të Kryetarit të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, stafi i ASHDMF ka qenë i angazhuar çdo ditë në terren, ku ishin sistemuar familjet dhe fëmijët e prekur nga tërmeti, në bashkitë Durrës, Shijak, Laç, Krujë, Vorë, Lezhë, Fushëkrujë, Shëngjin, Golem, Manzë, Bubq, Thumanë.

Ditët e para monitorimi dhe koordinimi u krye me dy turne, paradite dhe gjatë natës. Angazhimi i stafit të ASHDMF ka konsistuar në vlerësimin e situatës së fëmijëve dhe koordinimin e aktorëve që punonin pranë hoteleve ku ishin strehuar familje me fëmijë me qëllim evidentimin e nevojave emergjente materiale (ushqime, veshmbathje, produkte higjienosanitare, etj.) si dhe evidentimin e problematikave kryesore në menaxhimin e situatës pranë çdo hoteli.

Gjithashtu ASHDMF ka koordinuar bashkëpunimin mes organizatave dhe Urdhrit të Psikologut më synim verifikimin e situatës së fëmijëve dhe ofrimin e mbështetjes psikologjike post-traumatike sa më shpejt pas gjendjes së krijuar si dhe identifikimin e nevojave të tjera të fëmijëve. ASHDMF ka bashkëpunuar me partnerët e shoqërisë civile për ngritjen e mjediseve miqësore për fëmijët, pranë kampeve apo zonave ku ishin strehuar familjet e prekura. Janë organizuar vizita në terren për të vlerësuar ecurinë e procesit mësimor të rinisur pranë hoteleve ku ka patur fëmijë të sistemuar.

Gjatë periudhës 14 - 21 Shkurt 2020, ASHDMF në bashkëpunim me organizatat partnere ka realizuar 9 takime koordinuese në bashkitë e prekura nga tërmeti *Laç, Krujë, Lezhë, Vorë, Kamëz, Durrës, Shijak, Kavajë dhe Tiranë*, me përfaqësues të Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijës në bashki, punonjësit e mbrojtjes së fëmijës në njësitë administrative, përfaqësues të strukturave vendore,



përfaqësues të ASHDMF dhe të organizatave partnere për të vlerësuar më nga afër nevojat për mbështetje gjatë punës së tyre lidhur me menaxhimin e rasteve dhe nevojat për shërbime ndaj fëmijëve.

## ***2.2 Mbrojtja e fëmijëve gjatë pandemisë së COVID-19***

Në mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë shpalli shpërthimin e pandemisë COVID-19. Në këtë kontekst, në 24 mars 2020, në Shqipëri u shpall “Gjendja e Fatkeqësisë Natyrore”. Qeveria Shqiptare dhe autoritetet shëndetësore morën masa të menjëhershme për të përballur shpërthimin e COVID-19 në planin shëndetësor dhe ekonomik.

Pas këtij vendimi, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale miratoi Udhëzimin Nr. 253, datë 10.04.2020 *“Për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje gjatë periudhës së fatkeqësive natyrore për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”*.

Ky udhëzim përcakton procedurat dhe veprimet konkrete të strukturave të mbrojtjes së fëmijëve për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje gjatë periudhës së COVID-19.

Sipas Udhëzimit, punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve në bashki apo njësi administrative bashkëpunojnë me punonjësit shëndetësorë për të mbështetur, ndërgjegjësuar dhe informuar fëmijët dhe familjet e tyre për situatën e krijuar nga pandemia COVID-19, për masat parandaluese, shenjat dhe simptomat, për të identifikuar sëmundjen, për të komunikuar numrat e urgjencës, si dhe për të dhënë informacion se si mund të aksesojnë shërbimet në territorin ku jetojnë.

Dokumenti udhëzon punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve të ndihmojnë dhe mbështesin fëmijët në nevojë dhe familjet e tyre nëpërmjet telefonit ose mënyrave të tjera të komunikimit në distancë. Ata duhet t'u përmbahen protokolleve strikte të COVID-19, si distancimi social, përdorimi i pajisjeve mbrojtëse dhe masa të tjera higjienike dhe sanitare.

Strukturat e mbrojtjes së fëmijëve u udhëzuan t'i kushtojnë vëmendje të veçantë trajtimit të rasteve të mëposhtme:

- fëmijët pa kujdes prindëror, të cilët janë ndarë nga prindërit ose kujdestarët e tyre ligjorë për shkak të sëmundjes, duke përfshirë fëmijët në qendrat e izolimit dhe të urgjencës, qendrat e trajtimit ose kujdesin alternativ;
- fëmijët, prindërit ose kujdestarët e të cilëve janë të sëmurë, të karantinuar, të shtruar në spital ose kanë vdekur si pasojë e COVID-19;
- fëmijët në situatë rruge;
- fëmijët e izoluar në shtëpi që nuk kanë akses në shërbime, si fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët me sëmundje kronike;

- fëmijët e prekur nga sëmundja COVID-19, të cilët mund të mos pranohen nga familjet e tyre dhe/ose komuniteti;
- fëmijët, anëtarët e familjes së të cilëve janë të prekur nga COVID-19 dhe kështu nuk mund të kujdesen për fëmijën;
- fëmijët e dhunuar dhe të neglizhuar nga familjarët e tyre, të cilët janë edhe më të rrezikuar për shkak të masave të izolimit;
- migrantë ose azilkërkues fëmijë të pashoqëruar që janë ndarë nga prindërit e tyre

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ka ndarë dokumentin dhe ka udhëzuar strukturat e mbrojtjes së fëmijëve në nivel lokal në të gjithë Shqipërinë për të kuptuar dhe zbatuar siç duhet Udhëzimin.

ASHDMF ka kërkuar nga NJMF në të gjithë vendin të monitorojnë situatën për mbrojtjen e fëmijëve lidhur me dhunën në familje apo abuzimin seksual gjatë periudhës së karantinës së Covid 19.

Janë identifikuar 19 raste abuzimi seksual të fëmijëve gjatë periudhës së izolimit ndaj COVID, 17 nga të cilat janë menaxhuar nën monitorimin e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës. Këto kanë qënë kryesisht raste kur abuzimi kishte ndodhur më parë dhe gjatë periudhës së izolimit fëmijët apo familjarët morën guximin dhe i raportuan.

Po gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve në të gjithë vendin kanë raportuar edhe raste të formave të tjera të abuzimit të fëmijëve si:

- 21 raste të fëmijëve të dhunuar në familje, nga të cilët 15 fëmijë dëshmitarë të dhunës së ushtruar ndaj nënave të tyre, të cilat kanë marrë urdhër mbrojtje;
- 1 rast fëmije si viktimë e mundshme trafikimi;
- 2 fëmijë të braktisur të cilët janë sistemuar pranë institucioneve të përkujdesit shoqëror;
- 1 rast pa kujdes prindëror, për shkak të humbjes së jetës së babait në këtë periudhë dhe pamundësisë së nënës për t'u kujdesur për shkak të problemeve të shëndetit mendor;
- 1 foshnjë e kequshqyer, për shkak të pamundësisë së prindërve për të siguruar qumësht dhe ushqim për fëmijën.

### **3. Mbrojtja e fëmijëve në mjedisin digjital**

Siguria e fëmijëve në mjedisin digjital konsiderohet një sfidë e koheve të sotme. Në situatën aktuale ku fëmijët u detyruan prej pandemisë, të qëndrojnë shumë orë në internet, është rritur rreziku i ekspozimit të tyre online.

Ligji nr. 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës" parashikon mbrojtjen e fëmijëve nga çdo formë e dhunës dhe abuzimit, duke përfshirë ato forma të dhunës dhe abuzimit online. Siguron mbrojtjen e fëmijës nga qasja në materiale me përmbajtje të dëmshme ose të paligjshme në internet (neni 27).

Në VKM Nr. 465, datë 3.7.2019 "Për masat për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesimi në përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme në internet" është përcaktuar detyrimi i ASHMDF për shqyrtuar dhe raportuar raportimet mbi faqe/materiale me përmbajtje potencialisht të paligjshme dhe/ose të dëmshme për fëmijët në internet. Në këtë kuadër ASHMDF bashkëpunon me linjën Alo 116 111 raportimin e rasteve të tilla.

Për vitin 2020 janë raportuar 80 raste ku fëmijët kanë pësuar një nga format e dhunës online: janë ngacmuar seksualisht online, bullizuar, janë vjedhur adresat e rrjeteve sociale etj.

Për raportimin e këtyre rasteve ASHMDF ka bashkëpunuar me AKCESK. Në Portalin Online të administruar nga AKCESK janë raportuar faqet me përmbajtje të dëmshme ose të paligjshme për fëmijët të identifikuara.

Duke qenë se mbrojtja online për fëmijët është një fushë relativisht e re dhe jo shumë e njohur për Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve, ASHMDF ka bashkëpunuar me AKCESK dhe me Drejtorinë e Krimit Kibernetik për trajnimin e PMF-ve lidhur me mbrojtjen dhe sigurinë online të fëmijëve. Gjatë viti 2020 janë trajnuar PMF-të e qarkut Gjirokastrë dhe Shkodër.

ASHMDF ka marrë pjesë në disa takime të organizuara me aktorë të mbrojtjes dhe sigurisë kibernetike (AKCESK, AKEP, Policia e Shtetit) ku janë diskutuar sfidat dhe problematikat e sigurisë kibernetike oper fëmijët.

Në shkurt 2020, në kuadër të "Javës së internetit të sigurt për fëmijët", janë realizuar 4 takime informuese/ndërgjegjësuese me nxënësit në shkollat e bashkisë Tiranë: "Myslym Keta", "Hasan Vogli", "Lidhja e Prizrenit", "Kongresi i Lushnjës"

Gjatë sesioneve informuese mbi internetin e sigurt, ASHMDF prezantoi rrishtë ligjore për mbrojtjen dhe sigurinë online për fëmijët dhe të rinjtë. Në shkollën "Lidhja e Prizrenit" Ekipi dhe stafi i Agjencisë janë shoqëruar edhe nga ekspertë të fushës kibernetike, që informuan nxënësit mbi rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave, mënyrën e navigimit të sigurt në internet si dhe ku mund të raportojnë për rastet e abuzimit online, reklamën e padëshiruara etj. Fëmijët shprehën shqetësimin mbi bisedat online me të panjohur. ASHMDF nxiti fëmijët të referojnë dhe të kërkojnë ndihmë tek profesionistët në çdo rast kur ndihen të pasigurt ose të rrezikuar në internet. Gjatë këtyre takimeve janë shpërndarë broshura mbi raportimin online.

#### **4. Mbrojtja e fëmijëve shqiptarë të riatdhesuar dhe të huaj të pashoqëruar**

Me miratimin e VKM Nr.111, datë 06.03.2019 “Për Procedurat dhe Rregullat për Kthimin e Riatdhesimin e Fëmijës së Pashoqëruar” ASHDMF është autoriteti shtetëror përgjegjës, për të garantuar funksionimin e sistemit të integruar të mbrojtjes për fëmijët e pashoqëruar, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet bashkërendimit të punës midis autoriteteve përgjegjëse të përfshira në procesin e mbrojtjes.

Për vitin 2020 janë paraqitur 77 kërkesa për riatdhesim dhe janë **riatdhesuar 18 fëmijë të pashoqëruar shqiptarë**, kryesisht nga Suedia dhe Gjermania.

Fëmijet e riatdhesuar janë përgjithësisht të seksit mashkull dhe mosha e tyre varjon mesatarisht nga 16 vjec dhe lart.

ASHDMF referon kërkesën për vlerësim tek punonjësit për mbrojtjen e fëmijës panë bashkisë ose njesise administrative ku banon familja e fëmijës që do të riatdhesohet.

Përgjithësisht gjatë procesit të kthimit në vend, fëmijët janë pritur nga prinderit ose kujdestarët e tyre ligjorë.

Në tetor 2020 është realizuar kthimi i grupit të parë të **shqiptarëve nga zonat e konfliktit në Siri**. Të rikthyerit ishin 5 persona, 1 e rritur dhe 4 fëmijë. Procesi është menaxhuar nga Qendra Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE). ASHDMF ka qënë pjesë e grupit të punës që punoi për pritjen dhe rehabilitimin e fëmijëve të rikthyer. Bazuar në legjislacion, ASHDMF ka koordinuar punën e NJMF përkatëse gjatë vlerësimit të rasteve në qendrën e pritjes si dhe ka mbështetur NJMF me udhëzime teknike gjatë menaxhimit të rastit kur familjet u vendosën në komunitet.

Për vitin 2020 janë asistuar **40 raste të fëmijëve të huaj të pashoqëruar**. Fëmijët kryesisht kanë qënë nga Afganistani, Siria, Pakistani dhe Egjipti. Në momentin e identifikimit fëmijët nuk kanë pasur dokumenta identifikimi por kanë deklaruar se janë fëmijë dhe janë trajtuar si të tillë, bazuar në parashikimet ligjore në fuqi.

Punonjësit e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, punonjësit e Policisë së Shtetit apo të strukturave përgjegjëse për azilin ose refugjatët, brenda 12 orëve nga konstatimi apo njoftimi se në territorin e Republikës së Shqipërisë është paraqitur apo qëndron një fëmijë i pashoqëruar, referojnë rastin te punonjësi për mbrojtjen e fëmijës në territorin ku është konstatuar fëmija. Menjëherë pas referimit PMF sistemojnë fëmijën në një ambient të sigurt (Qëndër Emergjence) dhe fillojnë ndjekjen e procedurave për marrjen e masës emergjente të mbrojtjes. Gjatë Qëndrimit në qendrën e emergjencës por edhe me gjatë, fëmijët janë asistuar lidhur me nevojat e tyre bazik (ushqim, veshmbathje) si dhe për ta ofrohet ndihma psikologjike si dhe mundësia e një përkthyesi i cili bën të mundur komunikimin me fëmijën dhe informimin e tij në lidhje me procedurat e shtetit shqiptar.

Duke qënë një kategori e re e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës kanë hasur vështirësi në njohjen dhe kuptimin e procedurave të përcaktuara në VKM Nr 111 datë 06.03.2019. Mungesa e një qendre të specializuar për të sistemuar fëmijët e huaj të pashoqëruar ka paraqitur problematika gjatë menaxhimit të rastit. Fillimisht këta fëmijë janë vendosur pranë Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit, Babrru Tiranë, por tashme ky shërbim nuk ofrohet më nga kjo qendër dhe fëmijët vendosen në qendrat e emergjencës.

## 5. Mbrojtja e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht dhe në situatë rruge

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Femijes, nisur edhe nga situatat e vulnerabilitetit që krijoi COVID në vend, gjatë 2020 ka patur ne fokus mbrojtjen e femijeve nga trafikimi dhe shfrytezimi ekonomik. Është koordinuar puna me bashkitë për:

- a) ngritjen e skuadrave te terrenit me qëllim identifikimin e hershëm, referimin dhe ndihmën e menjhershme për rastet në situatë shfrytezimi ekonomik,
- b) forcimin e kapaciteteve te profesionistëve mbi menaxhimin e rasteve fëmijëve viktime të trafikimit apo viktime të mundshme trafikimi;
- c) përfshirjen e objektivave konkrete për mbrojtjen e femijeve te trafikuar apo shfrytezuar ekonomikisht në planet lokale të hartuara nga bashkitë;
- d) organizimi i fushatave te ndergjegjesimit dhe informimit mbi trafikimin

Per 2020 PMF në të gjithë vendin kanë menaxhuar **150 raste te femijeve te identifikuar ne situatë rruge dhe 58 raste të fëmijëve viktime/viktima të mundshme trafikimi.**

Në korrik u lancua studimi “*Tipologji e trafikimit të fëmijëve në Shqipëri*”, i përgatitur nga ASHDMF në bashkëpunim me prezencën e OSBE-së në Shqipëri. Studimi synon të kuptojë më mirë se si funksionon sistemi i mbrojtjes së fëmijës në Shqipëri në lidhje me rastet e fëmijëve të identifikuar si viktime të mundshme dhe viktime të trafikimit. Studimi u mbështetet në të dhëna të hollësishme nga 45 raste të menaxhuara nga Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës në 11 bashki.

Janë analizuar llojet e shfrytëzimit të fëmijëve të hasura në secilin rast, duke përdorur kuadrin ligjor ndërkombëtar lidhur me punën e fëmijëve, përfshirë dhe trafikimin e fëmijëve. Ky studim merr në shqyrtim rolin dhe funksionimin e strukturave si dhe të procedurave aktuale për mbrojtjen e fëmijës në Shqipëri, në veçanti në lidhje me punonjësit e mbrojtjes së fëmijës, policinë, shërbimet sociale shtetërore dhe ato që ofrohen nga OJF-të, si dhe shkollat. Studimi shqyrton përmbushjen e standardeve të përcaktuara në legjislacionin dhe politikën përkatëse në Shqipëri

Në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërministror ndërmjet MAS, MB dhe MSHMS ” *Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor*” si dhe në detyrimet ligjore që ka Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF), të përcaktuara ne Ligjin 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, NJMF-të kanë bashkëpunuar me shkollat dhe

Njësitë Arsimore Vendore për identifikimin e fëmijëve që nuk frekuentojnë shkollën dhe regjistrimin e tyre në në ciklin e arsimit të detyruar. ASHDMF cdo vit në shtator mbledh nga NJMF listën e fëmijëve që duhet të ndjekin arsimin e detyruar. Lista dërgohet pranë MAS që siguron regjistrimin e tyre në shkollat përkatëse.

PMF kanë identifikuar **289 raste** të fëmijëve në nevojë për mbrojtje që për arsye të ndryshme nuk kanë akses apo kanë braktisur shkollën, të cilët duhet të për rregjistrohen për ndjekjen e arsimit të detyruar për vitin shkollor 2020 – 2021. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit kanë siguruar regjistrimin e tyre në shkolla.

## **6. Monitorimi i të drejtave të femijeve**

### ***6.1 Monitorimi i respektimit të të drejtave të fëmijëve në raportimet e medias***

ASHDMF monitoron në mënyrë të përditshme mediat me qëllim evidentimin dhe referimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të fëmijëve në raportimet e mediave të shkruara dhe audiovizive. Rastet e shkeljes së të drejtave referohen pranë autoriteteve përgjegjëse me synim përmirësimin e situatës mediatike të raportimet të rasteve të fëmijëve.

Kodi i Transmetimit ka ndryshuar duke rritur mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në mediat audiovizive. ASHDMF ka bashkëpunuar ngushtë me Autoritetin e Mediave Audiovizive me qëllim përmirësimin e situatës së respektimit të të drejtave të fëmijëve.

Nga monitorimi i medias gjatë vitit 2020 janë evidentuar **11 raste** të shkeljes flagrante të të drejtës së fëmijës. Rastet janë referuar pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), që ka reaguar me shpejtësi duke i dërguar shkresë zyrtare televizioneve, ku i terheq vemendjen për shkeljen e të drejtave të fëmijëve.

Duke synuar respektimin, promovimin e të drejtave të fëmijëve si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijëve në fushën e shërbimeve audio dhe/ose audiovizive; ASHDMF nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi me Autoritetin e Mediave Audiovizive, në datë 30 dhjetor 2020, që synon rritjen e bashkëpunimit dhe përmirësimin e situatës së raportimit të rasteve të shkeljes së të drejtave të fëmijëve në mediat audiovizive.

Për rastet kur cënimi i të drejtave të fëmijës është bërë përmes portaleve dhe mediave online, Autoriteti i Mediave Audiovizive nuk ka hapësirë ligjore për të vepruar. ASHDMF ka kërkuar bashkëpunimin me Këshillit Shqiptar të Medias (organizatë e pavaruar gazetarësh) që synon krijimin e medias së pavaruar, etike dhe profesionale në Shqipëri. KSHM ka ndërhyrë në tre raste pranë portaleve dhe mediave online duke bërë të mundur fshirjen e këtyre lajmeve.

ASHDMF ka fokus të veçantë në punën me aktorë të ndryshëm të përfshirë në çështje që lidhen me zbatimin e të drejtave të fëmijëve gjatë raportimit në media.

ASHDMF ka qënë pjesë e panelit të diskutimit “*Fëmijët dhe shprehjet e edukimit mediatik*”, të organizuar në datë 17.12.2020, së bashku me nga OSHMA-të kombëtare dhe lokale, nga institucionet publike, nga shoqëria civile, media etj. ASHDMF tërhoqi vëmëndjen e aktorëve pjesmarrës mbi rëndësinë e edukimit mediatik për fëmijët. Publikimi i lajmeve të pavërteta apo të shtrembëruara, diskriminimi dëmtojnë formimin e fëmijëve.

ASHDMF ka qënë një nga aktorët në Panelin virtual të diskutimit “*Reklammat për fëmijë dhe me fëmijët*” mbajtur në datë 06.10.2020. Në panel u diskutua mbi ankesat që vijnë nga individë apo subjekte, monitorimi dhe shqyrtimi i përmbajtjeve të reklamave të transmetuara dhe përmirësimi i akteve nënligjore mbi reklammat për fëmijë dhe me fëmijë.

Në Ditën Botërore të Radios, 13 shkurt 2020, ASHDMF mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar nga Autoritetit të Mediave Audiovizive “*Sfidat e radios në erën dixhitale*” që synoi të tërheqë vëmëndjen ndaj rolit dhe ndikimit të këtij mediumi në shoqëri, hapësirën e komunikimit dhe interaktivitetin mes gjeneratave. ASHDMF diskutoi me të pranishmit mbi rëndësinë që ka ky medium si një mjet masiv edukimi, për promovimin e të drejtave të fëmijëve si dhe përcjelljen e zërit të fëmijëve në këtë medium si parim themelor për respektimin e të drejtave të fëmijëve.

## ***6.2 Monitorimi i situatës së të drejtave të fëmijëve nëpërmjet mbledhjes së të dhënave statistikore në nivel kombëtar.***

Bazuar në ligjin 18/2017 “*Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës*” ASHDMF ka përgjegjësinë të realizojë mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore për çështjet që lidhen me të drejtat e fëmijëve në bashkëpunim me institucionet qendrore dhe INSTAT. Në bazë të VKM Nr. 636, datë 26.10.2018 “*Për përcaktimin e llojeve, të mënyrës së shkëmbimit e të përpunimit të informacionit e të dhënave statistikore, të kërkuara nga ASHDMF e nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor*”, Agjencia mbledh të dhëna statistikore vjetore nga Ministrinë e Linjës/institucionet qendrore dhe INSTAT bazuar në listën e treguesve bashkëlidhur këtij vendimi.

Treguesit janë të ndarë në 6 fusha, mbrojtja sociale, arsimit, mbrojtja e fëmijëve nga dhuna/abuzimi fizik, shëndetësia, aksesit në drejtësi dhe drejtësia për të mitur. Agjencia ka bashkëpunuar me ekspert të UNICEF për ndërtimin e një platforme dixhitale online për paraqitjen e të dhënave lidhur me çështjet e të drejtave të fëmijëve. Në vazhdimësi ASHDMF po punon me UNICEF për ngritjen e sistemit dhe hedhjen e të dhënave dhe informacionit statistikor zyrtar në lidhje me realizimin e të drejtave të fëmijëve në vite.

## **7. Rritja e kapaciteteve të profesionistëve në kuadër të zbatimit të ligjit dhe mbrojtjes së fëmijëve**

Gjatë vitit 2020 trajnimet dhe rritjet e kapaciteteve të profesionistëve u fokusuan më tepër në aftësisimin për përballimin e situatave emergjente që kaloi vendi për arsye të tërmetit dhe COVID 19.

- Takime periodike javore online u organizuan nga ASHDMF, UNICEF dhe PMF gjatë periudhës së pandemisë. Në këto takime punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve u është dhënë mbështetje teknike për menaxhimin e rasteve të evidentuara dhe procedurat që duhen ndjekur. Janë shpërndarë broshura me udhëzime praktike mbi menaxhimin e situatës së pandemisë.
- Më 8 maj 2020 u mbajt një ëebinar nga ASHDMF, OSBE dhe NJMF mbi situatën e krijuar nga COVID 19. U theksua roli i ASHDMF si partneri kryesor i Prezencës së OSBE-së në luftën kundër trafikimit dhe shfrytëzimit të fëmijëve. U diskutua mbi masat konkrete të ndërmarra në nivel vendor për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi edhe në periudhën fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga koronavirusi, si dhe gjatë sezonit turistik.
- Më 27 maj filloi trajnimi online i OBSH “Shëndeti Mendor dhe Mbështetja Psikosociale në Situata Emergjente”, i cili synonte të përgatiste profesionistët e linjës së parë me njohuritë dhe mjetet për të mbrojtur dhe përmirësuar shëndetin mendor dhe mirëqenien psikosociale të individëve gjatë situatave emergjente. Ishte një trajnim 8-javor me përfshirjen e profesionistëve shëndetësorë dhe punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve. Një nga sesionet e trajnimit trajtoi temën: Dhuna seksuale dhe me bazë gjinore gjatë emergjencave humanitare.

Trajnime të tjera janë organizuar edhe për njohjen e zbatimin e politikave të reja të ndërmarra në fushën e të drejtave të fëmijëve si dhe për rritjen e kapaciteteve të aktorëve vendor gjatë procesit të menaxhimit të rastit

- ASHDMF ka bashkëpunuar me AKCESK dhe me Drejtorinë e Krimin Kibernetik për trajnimin e PMF-ve lidhur me mbrojtjen dhe sigurinë online të fëmijëve. Gjatë viti 2020 janë trajnuar PMF-të e qarkut Gjirokastër dhe Shkodër. Mbrojtja e fëmijëve online është një fushë e re për PMF. Trajnimet do të zhvillohen edhe për PMF e tjera në të ardhmen.
- Jane vlerësuar nevojat për trajnim të NJMF dhe profesionistëve në nivel vendor që punojnë me fëmijet. Për të gjithë këta aktore që janë pjesë e administratës publike, ASPA ka filluar trajnimin "Kuptimi i fëmijërisë dhe sistemit të mbrojtjes sociale në Shqipëri". Ky trajnim po organizohet në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe mbështetjen e Tdh dhe UNICEF.



- Gjate korrik 2020, ASHDMF ka organizuar takime online ne 5 bashki per promovimin e Udhezuesit per pjesmarjen e femijeve, te miratuar me Urdher te Ministrit te MSHMS. Ne keto takime kane marre pjese NJMF, mesues, psikologe shkollor punonjes sociale nga qendrat e ndryshme te sherbimeve sociale ne bashki.

## 8. Aktivitete sensibilizuese dhe aktivitete në kuadër të ditëve të shënuara

Për arsye të masave shtrënguese lidhur me distancimin social gjatë periudhës së COVID – 19, aktivitetet e parashikuar janë realizuar online. Gjatë gjysmës së dutë të vitit 2020, ASHDMF filloi aktivitetet ndërgjegjësuese në terren.

Në **shkurt 2020, në kuadër të “Javës së internetit të sigurt për fëmijët”**, janë realizuar 4 takime informuese/ndërgjegjësuese me nxënësit në shkollat e bashkisë Tiranë: “Myslym Keta”, “Hasan Vogli”, “Lidhja e Prizrenit”, “Kongresi i Lushnjes”. Gjatë sesioneve informuese mbi internetin e sigurt, ASHDMF prezantoi risitë ligjore për mbrojtjen dhe sigurinë online për fëmijët dhe të rinjtë. ASHDMF nxit fëmijët dhe mësuesit të raportojnë. Gjatë këtyre takimeve janë shpërndarë broshura mbi raportimin online.

**Në kuadër të 10 Tetorit Dita Botërore e Shëndetit Mendor**, u lancua për profesionistet studimi “Ndikimi i pandemisë së shkaktuar për shkak të Covid19 tek shëndeti mendor i fëmijëve”, që synon të sjellë në vëmendje rëndësinë e identifikimit dhe trajtimit të hershem të problemeve të shëndetit mendor tek fëmijët apo prindërve të tyre. Njohja e shërbimeve dhe ndarja e eksperiencave në menaxhimin e rasteve të fëmijëve me probleme të shëndetit mendor ishte në fokus të takimit të organizuar nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës me profesionistet në fushën mbrojtjes së femijës

Gjatë muajit Tetor, **në kuadër të muajit antitrafik**, nen koordinimin e ASHMDF, NJMF kanë organizuar aktivitete ndërgjegjesimi kundër fenomenit të trafikimit të fëmijëve, ne 61 bashkite e vendit.

Në kuadër të **18 Nëntorit Ditës Evropiane për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual**, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës filloi *Fushatën Ndërgjegjësuese “Kujdes nuk është lojë!”* Kjo fushatë u bazua në nismën e Këshillit të Europës për parandalimin e sjelljeve të rrezikshme tek fëmijët. ASHDMF organizoi fushatën gjatë muajve nëntor – dhjetor 2020.

“Ngrije zërin!”, “Raporto dhunën, abuzimin dhe neglizhimin!” ishin mesazhet që ju përcollën fëmijëve. Ndërgjegjësimi dhe informacioni mbi rreziqet që ekspozohen fëmijët e moshave 6 -17 vjeç gjatë përdorimit të internetit.

Një nga format më të përhapura është edhe ajo e shantazhimit apo kërcënimit duke rrezikuar jetën e fëmijëve deri tek fenomeni i trafikimit. Fushata fillimisht u lancua në bashkinë Bulqizë. Në

bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri dhe Ministrinë e Brendshme Punonjësen për Mbrojtjen e Fëmijës, specialistët antitrafik dhe aktorët vendor të Bashkisë Bulqizë u diskutua edhe mbi ecurinë e punës për menaxhimin e rasteve të fëmijëve viktime trafikimit, abuzimit seksual për nxitjen e identifikimit proaktiv dhe raportimit.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në bashkëpunim me NJMF përkatëse realizoi fushatën ndërgjegjësuese në bashkitë: Patos, Fier, Lushnjë, Memaliaj, Vlorë, Divjakë dhe Shkodër.

Në kuadër të **20 Nëntorit Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve**, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës zgjodhi Bashkinë Kukës për të organizuar një aktivitet promovues mbi të drejtat e fëmijëve. ASHDMF në përputhje me rolin për mobilizimin e të gjithë aktorëve për të rritur pjesmarrjen e të gjitha kategorive të fëmijëve në aktivitete, procese vendimarrjeje, dëgjesa publike për nevojat e tyre të cilat duhet të jenë pjesë e prioritetëve të institucioneve në nivel lokal apo qëndror, organizate apo grupi interesi, media etj.

Në kuadër të javës së të drejtave të fëmijëve, Kryetarja e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës Znj. Alma Tandili realizoi një takim online informues dhe ndërgjegjësuës me nxënësit e shkollës 9 vjecare “Emin Duraku” në lidhje me realizimin e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijëve. Së bashku me PMF në Njësinë Administrative nr. 5 u diskutua në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, abuzimi, shfrytëzimi dhe neglizhimi dhe mënyrën e raportimit të këtyre rasteve pranë institucioneve përgjegjëse.

**Në 3 dhjetor 2020, në kuadër të Ditës Botërore së Aftësisë së Kufizuar**, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ka realizuar një takim në bashkinë Kukës për promovimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi ndryshe, gjithëpërfshirjen dhe mbrojtjen e tyre në mënyre të veçantë në identifikimin e nevojave dhe referimin e tyre për shërbime të aksesueshme në familje shkolla, komunitet.

Me **rastin e festave të fundvitit**, Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës sëbashku me bashkinë Kamëz dhe përfaqësues të Ancora International Foundation organizuar një aktivitet argëtues dhe ndanë emocione të veçanta me fëmijët me aftësi ndryshe, të prekur nga tërmeti, fëmijë në nevojë për mbrojtje.

## **9. Raportime ndërkombëtare dhe në kuadër të integritit evropian**

Gjatë 2020, ASHDMF si pjesë e grupeve ndërinstitucionale të punës të ngritura në kuadër të procesit “screening” për përfaqësimin e legjislacionit kombëtar me acqius të BE ka dhënë kontributin e saj lidhur me analizën e direktivave të BE që kanë të bëjnë me fëmijët.

Ligji 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij janë analizuar në kuadër të Direktivave të BE, për 4 kapituj të Planit Kombëtar për Integritin Evropian.

Konkretisht gjatë procesit të punës janë plotësuar Tabelat e Kapaciteteve Administrative dhe Tabelat e Përputhshmërisë (LGA) për direktivat që kanë të bëjnë me fëmijët për Kapitujt:

- Kapitulli 19 “Politikat Sociale dhe Punesimi” në bashkëpunim me institucionin udhëheqës, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe Të Drejtat Themelore” në bashkëpunim me institucionet udhëheqëse, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë për Punët e Jashtme dhe Integrimin Evropian
- Kapitulli 24 “Drejtesia, Liria dhe Siguria” në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe institucionin udhëheqës Ministrinë e Brendshme
- Kapitulli 28 “Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndeti” në bashkëpunim me MSHMS dhe institucionin udhëheqës Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë.

ASHDMF, si pjesë e grupit të punës, ka kontribuar edhe në hartimin e Planin Kombëtar të Integritimit Evropian 2020 - 2022.

Përfaqësues të ASHDMF kanë marrë pjesë në takimet periodike të komiteteve të Këshillit të Evropës për të drejtat e fëmijës dhe ka dhënë raportimet përkatëse për:

- Komitetin e Lanzarotes, që monitoron zbatimin e Konventës së Lanzarotes për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi seksual
- Steering Committee for the Rights of the Child (**CDENF**). Në takimet e CDENF është hartuar dhe Strategjia e re Europiane për të Drejtat e Fëmijës 2022- 2027.

Mbledhjet e komiteteve janë mbajtur sipas kalendarit të përcaktuar nga këto komitete, kryesisht online. Vendi ynë ka dhënë informacion lidhur me zhvillimet në vend dhe veprimet e ndermarra për mbrojtjen e fëmijëve lidhur me përballimin e situatës së COVID 19.

ASHDMF ka dhënë komente për Udhezuesin e dërguar nga Këshilli i Europës "Udhezues për të respektuar, mbrojtur dhe plotësuar të drejtat e fëmijëve në mjedisin digjital". Udhezuesi është shpërndarë për tu testuar me grupet e fëmijëve të grupmoshave 7-18 vjeç, për tu përshtatur në një gjuhë sa më të thjeshtë dhe të kuptueshme nga fëmijët.

Strategjia e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijës (2016-2021) ka identifikuar si një ndër fushat prioritare mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në mjedisin dixhital. Në këtë kuadër është ndërmarrë projekti “End Online Child Sexual Exploitation and Abuse @ Europe”, që synon të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve nëpërmjet bashkëpunimit efektiv multi-kombëtar, ndërdisiplinor dhe ndërsektorial dhe marrjes së masave të përshtatshme për fëmijët për të parandaluar dhe luftuar shfrytëzimin dhe abuzimin seksual të fëmijëve të lehtësuar nga TIK (OCSEA) në nivel pan-evropian.

Gjatë 2020, ASHDMF ka marrë pjesë në takimet e grupit të punës të End of OCSEA të organizuar nga Këshilli i Europës, ku Shqipëria dha informacion mbi zhvillimet dhe programet që po implementohen në vendin tonë me qëllim mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna e abuzimi online si dhe masat që janë marrë për mbrojtjen e fëmijëve gjatë kohës së pandemisë së COVID..

## **10. Mbështeteja e ASHDMF me Burime Njerëzore**

Në kuadër të Planit të Aksionit midis Bashkimit Europian dhe qeverisë së Republikës së Shqipërisë, Agjencia për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve dhe UNICEF Shqipëri lidhën marrëveshjen e bashëpunimit me UNICEF me datë 13 Qershor 2019. Marrëveshja kishte për qëllim të kontribuonte në zhvillimin dhe forcimin institucional të Agjencisë nëpërmjet krijimit të një Ekipi Lëvizës që do të mbështesë Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve me këshilla teknike dhe për të adresuar nevojat e tyre për fuqizim kapacitetesh në territorin ku ata veprojnë. Fokusi i punës së Ekipit Lëvizës konsistonte në arritjen e objektivave:

1. Rritje të raportimit të rasteve nga NJMF/PMF e bashkive që aktualisht raportojnë 0-3 raste, si dhe
2. Nxitja dhe inkurajimi i sektorëve të shëndetësisë dhe arsimit për të rritur numrin e identifikimit dhe raportimit tek NJMF/PMF të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Në kuadër të projektit për fuqizimin e kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes së fëmijëve në të gjithë vendin, Ekipi Lëvizës gjatë periudhës Korrik 2019 – Qershor 2020 ka realizuar takime në 34 bashki: Berat, Ura Vajgurore, Kuçovë, Poliçan, Bulqizë, Durrës, Krujë, Belsh, Gramsh, Librazhd, Patos, Roskovec, Lushnje, Gjirokastër, Libohovë, Memaliaj, Dropull, Korçë, Krumë, Rrëshen, Malësi e Madhe, Shkodër, Pukë, Tiranë, Vorë, Vlorë, Pogradec, Pustec, Devoll, Klos, Finiq, Konispol, Delvinë dhe Tropojë. Këto bashki janë identifikuar nga ASHDMF si bashki me raportim shumë të ulët të rasteve (1-3 raste) ose bashki të cilat nuk kanë identifikuar/raportuar asnjë rast të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Takimet janë organizuar me njësitë e mbrojtjes së fëmijës, si dhe me strukturat e shëndetësisë dhe arsimit për arsye të numrit të ulët të rasteve të raportuara nga këto struktura, por edhe me aktorë të tjerë lokalë të cilët janë pjesë e grupeve teknike ndërsektoriale në nivel vendor. Në takime kanë marrë pjesë rreth 80 profesionistë që punojnë me fëmijët në nivel vendor.

Në kuadër të nxitjes së strukturave vendore për realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre nga dhuna e abuzimi, Ekipi Lëvizës ka realizuar 7 aktivitete ndërgjegjësuese/informuese në 4 bashki të vendit.

Duke nisur nga ngjarjet e emergjencave civile të ndodhur gjatë periudhës 2019 - 2020, puna ASHDMF ka ndryshuar fokusin në përshtatje të nevojave emergjente. Gjatë kësaj periudhe edhe puna e Ekipit Lëvizës është fokusuar në mbështetejen e ASHDMF për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve të prekur nga tërmeti dhe gjatë pandemisë së shkaktuar nga COVID-19.

## REKOMANDIMET

- Dhuna fizike dhe abuzimi seksual janë format më të rënda të dhunës, por gjatë periudhës së pandemisë së fundmi janë vërejtur edhe forma të tjera dhune si ngacmimi, bullizmi online, që kanë shfaqur problematika po aq të rënda tek fëmijët dhe familjet e tyre e duhet të adresohen nga profesionistët në nivel vendor.
- Planet e emergjencave civile në nivel qendror e vendor duhet të reflektojnë nevojat për mbështetje e shërbime edhe për fëmijët
- Ngritja e shërbimeve të reja të specializuara për kategori të veçanta të fëmijëve si: fëmijë të abuzuar seksualisht, fëmijë të huaj të pashoqëruar, fëmijë përdorues të lëndëve narkotike
- NJMF/PMF është e nevojshme të mbështeten lidhur me trajtimin e fëmijëve që i përkasin grupeve të reja që duhet të merren në mbrojtje si: fëmijë në konflikt me ligjin (nën dhe mbi moshën e përgjegjësisë penale), fëmijë të huaj të pashoqëruar, fëmijët që riatdhesohen, fëmijët e rikthyer nga zonat e luftës e konfliktit etj.
- Parandalimi i dhunës apo abuzimit ndaj fëmijëve duhet të jetë në fokus të profesionistëve që punojnë me fëmijët në nivel vendor. Identifikim i hershëm dhe proaktiv i fëmijëve që janë në situata të rrezikut për dhunë dhe abuzim, si dhe në situata të shfrytëzimit për punë nuk duhet të jetë detyrë vetëm e PMF. Profesionistët vendorë si: mjeku, mesuesi, apo cdo profesionist tjetër që dyshon apo ka dijeni për ndonjë rast abuzimi me fëmijë, duhet të zbatojnë ligjin duke vënë në dijeni PMF ose policinë nëse është e nevojshme.
- Rritja dhe forcimi i kapaciteteve të punonjësve për mbrojtjen e fëmijës dhe aktorëve vendor mbetet domosdoshmëri. Lëvizjet e shumta të stafëve vendorë të punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve kërkojnë rritje të kapaciteteve profesionale të tyre në mënyrë të shpeshtë.
- Rritje e vemendjes dhe mbështetjes për fëmijët që janë në familje me ndihmë ekonomike, shtresa e cila paraqet rrezik të shfrytëzimit seksual ose punës së detyruar. Bashkitë duhet të sigurojnë shtimin e burimeve vjetore nëpërmjet fondeve specifike që sigurojnë nevojat për strehim, punësim dhe zhvillim urban të familjeve të varfra dhe me pamundësi ekonomike.
- Promovimi i buxhetimit me në qendër fëmijën, kryesisht në ofrimin e shërbimeve në nivelin lokal. Fondet lokale të bashkive duhet të kenë një linjë buxhetore për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

- Orientimi i fondeve të donatorëve drejt përmirësimit dhe vendosjes së shërbimeve të drejtpërdrejta dhe efikase për fëmijët në nevojë.
- Rritja e stafit dhe buxhetit për Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve si institucioni kryesor qeveritar i cili kujdeset për koordinimin e sistemin e mbrojtjes së fëmijëve dhe promovimin e të drejtave të fëmijës.